



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 28

Prishtinë, më 7.12.2015 ora: 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Procesverbal

i mbledhjes së Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaqi, Alma Lama, Jelena Bontiq.

Mungoi: Shqipe Pantina, Pal Lekaj dhe Zafir Berisha

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit e zyrës ligjore të Ministrisë së Administratës Publike, ZPRK, KDI-së, ZPRK-së, RTV21, Rrokum TV, News TV.

Nga Staf i mbështetës i Komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për procedurën e përgjithshme administrative;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për procedurën e përgjithshme administrative

Zenun Pajaziti, hapi mbledhjen dhe kërkoi nga z. Sadri Ferati, i cili ishte kryesues i grupit punues për të hartuar amendamentet në Projektligjin për procedurën e përgjithshme administrative, që të sqarojë propozim - ndryshimet në projektligj.

Sadri Ferati, propozoi që të diskutohet për disa nene të tekstit të projektligjit.

Për nenin 40, pika 3, në tekstin e projektligjit lidhur me atë se pjesëmarrja e 1/3 së anëtarëve mund të konsiderohet kuorum për vendimarrje.

Alma Lama, pyeti përfaqësuesit e MAP-së se nga cilat praktika ligjvënëse është marrë teksti i nenit të sipërhënuar dhe kërkoi sqarime lidhur me nenin. Në këtë kontekst, ajo theksoi se nuk

mund të merren vendime me 1/3 e anëtarëve. Gjithashtu propozoi rishkrimin e tekstit të nenit për masat ndëshkimore ndaj atyre që me anë të mospjesëmarrjes në mbledhje të përcaktojnë rrjedhën e vendimeve.

Po ashtu, kërkoi që pika dy e nenit 40 e tekstit të projektligjit, të ndryshohet d.m.th. të mos mbetet teksti i projektligjit, përderisa për të njëjtën pikë Komisioni vendosi me 5 vota për, që teksti i nenit 40, pika dy të mbetet e njëjtë pa ndryshime.

Naser Shamolli, drejtor i Zyrës Ligjore të MAP-së, lidhur me pyetjen e deputetes, u përgjigj se nëse inkorporohen masat ndëshkimore, duhet të inkorporohen dhe të përcaktohen me ligje të veçanta.

Konstatim: Komisioni vendosi me shumicë votash për dhe 1 kundër nga znj. Alma Lama, që të fshihet pika e tretë e nenit 40.

Sadri Ferati, lidhur me nenin 100 të tekstit të projektligjit dhe nenin 160 të projektligjit, të mbeten pa ndryshime.

Komisioni, gjithashtu, diskutoi lidhur me përkufizimet se çka është akti real, prestacioni dhe procedura administrative.

Alma Lama, lidhur me përkufizimet, propozoi se po qe se nuk ka propozime për përkufizime të tjera, përveç atyre të sipërsënuara, atëherë ato mbesin në tekst pa ndryshime. Ajo theksoi se projektligji nuk mund të procedohet pa përkufizime, sepse kjo është standard për secilin projektligj.

Sadri Ferati, propozoi që projektligji të votohet në tërësi me propozim- ndryshimet e hartuara nga Komisioni.

Konstatim: Komisioni votoi me 5 vota për dhe 1 abstenim nga znj. Alma Lama, propozim-ndryshimet si vijon:

Amendamenti 1

Përkufizimi për akte reale, procedurën administrative dhe prestacionin.

Amendamenti 2

Në tërë tekstin e projektligjit, fjalët: **“për sa është e mundur”**, zëvendësohen me fjalën **“përshtatshmërisht”**.

Amendamenti 3

Në tërë tekstin e projektligjit, fshihen fjalët: **“apo diskrecioni”**.

Amendamenti 4

Neni 4, paragrafi 1, fshihen fjalët: **“legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar të zbatueshëm në Republikën e Kosovës”** dhe zëvendësohen me fjalët: **“legjislacionin në fuqi,** si dhe fjalët: **“kufijve të”** dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 5

Neni 9.3, riformulohet si vijon: “Të drejtat e parashikuara nga ky nen, kufizohen me ligj, kur është e domosdoshme për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, të të dhënave personale apo të dhënave afariste e profesionale, të mbrojtura sipas ligjit”.

Amendamenti 6

Neni 10. Paragrafi 2, riformulohet si vijon: “Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative”.

Amendamenti 7

Neni 11, paragrafi 1, fshihet fjala “**kujdeset**” dhe zëvendësohet me fjalën “**siguron**”.

Amendamenti 8

Neni 11, paragrafi 2, në fund të këtij paragrafi, fshihen fjalët: “**dhe interesin publik**”.

Amendamenti 9

Neni 15, paragrafi 1, riformulohet si vijon: “Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj, zotësia për t vepruar e një personi fizik apo juridik, në procedurën administrative, përcaktohet sipas dispozitave përkatëse të legjislacionit civil”.

Amendamenti 10

Neni 15 paragrafi 3. riformulohet si vijon: “Organi publik, palë në një procedurë administrative, vepron nëpërmjet titullarit të tij, përfaqësuesit ligjor apo të autorizuar të caktuar sipas ligjit”.

Amendamenti 11

Neni 16. Paragrafi 2. fshihen fjalët: “**rastin e parashikuar**”, zëvendësohen me fjalët “**rastet e parashikuara** “ dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 12

Neni 17, paragrafi 1, fshihet fjala “**një**” zëvendësohet me “**e**”.

Amendamenti 13

Neni 17 paragrafi 4, ndryshohet si vijon: “Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj, dispozitat përkatëse të legjislacionit civil mbi përfaqësimin, zbatohen, përshtatshmërisht në procedurën administrative”.

Amendamenti 14

Neni 18.1, tek teksti i projektligjit në gjuhën angleze, referenca ndryshohet sipas nenit 17.

Amendamenti 15

Neni 19.2, fjalët: “**Përveç sa**” zëvendësohen me fjalët: “**Përveçse, siç**”, vazhdon teksti.

Amendamenti 16

Neni 20.4, riformulohet si vijon: “Kur përfaqësuesi i autorizuar jep një deklaratë me gojë, pala e pranishme, mund ta zhvlerësojë apo tërheqë atë, aty për aty”.

Amendamenti 17

Neni 23, paragrafi 2, në fillim të paragrafit, fshihet fjala **“Përjashtimisht”** dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 18

Neni 24, paragrafi 1, fjala **“kryesisht”**, zëvendësohet me fjalët: **“sipas detyrës zyrtare”** dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 19

Neni 29, paragrafi 1.1, riformulohet si vijon: “Kur me palën, me përfaqësuesin ligjor apo me të autorizuarin e palës, është në gjini të gjakut, në vijë të drejtë deri në cilëndo shkallë, kurse në vijë të tërthortë deri në shkallë të katërt, apo në qoftë se është bashkëshort apo në gjini të krushqisë deri në shkallë të dytë, pavarësisht nëse martesë ka pushuar ose jo”.

Amendamenti 20

Neni 33, paragrafi 3.1, në fund të këtij paragrafi, fshihen fjalët: **“në rast mosmarrëveshjeje”**.

Amendamenti 21

Neni 40, paragrafi 3, fshihet në tërësi.

Amendamenti 22

Neni 48. 1, fshihen fjalët: “dhe që të ushtrojë mjetet juridike ndaj tij” dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 23

Neni 58, paragrafi 2, pas fjalës **“nga”**, shtohet fjala **“data”**, si dhe **“4 vjet”**, zëvendësohet me **“5 vjet”**.

Amendamenti 24

Neni 67, në fund të këtij paragrafi, fjalët: **“për aq sa është e mundur edhe për kontratën administrative”**, zëvendësohen me fjalët: **“përshtatshmërisht, edhe për interpretimin, vlefshmërinë si dhe zbatimin e kontratës administrative”**.

Amendamenti 25

Neni 75, në titullin e nenit 75, fjala **“organit”**, zëvendësohet me fjalën **“organi”**.

Amendamenti 26

Neni 80, paragrafi 1, fshihen fjalët: **“do të merr një vendim”**, zëvendësohen me fjalën **“vendos”**.

Amendamenti 27

Neni 80, paragrafi 2, fshihen fjalët: **”për shkak të ligjit”**, zëvendësohet me fjalën **”sipas ligjit”**.

Amendamenti 28

Neni 82, paragrafi 4, neni **“68”**, zëvendësohet me nenin **“75”**.

Amendamenti 29

Neni 85, paragrafi 3, riformulohet si vijon: **“Kur procedura për zgjidhjen e çështjes paraprake mund të fillohet vetëm sipas detyrës zyrtare nga organi tjetër, organi për zgjidhjen e çështjes do të kërkojë nga organi tjetër fillimin e procedurës për zgjidhjen e çështjes paraprake”**.

Amendamenti 30

Neni 88, paragrafi 1, fshihet fjala **“legjislacioni”**, zëvendësohet me fjalën **“ligji”**, ndërsa fjalia e dytë fshihet në tërësi.

Amendamenti 31

Neni 100, paragrafi 1, fshihen fjalët: **“nuk njofton një”**, zëvendësohen me fjalët: **“nuk e njofton palën për aktin administrativ”**, ndërsa pas fjalëve: **“apo nuk njofton”** shtohet fjala **“për”**.

Të harmonizohet teksti i gjuhës angleze me tekstin në gjuhën shqipe.

Amendamenti 32

Neni 105, në titullin e këtij neni, pas fjalës **“ dokumenteve”**, shtohen fjalët: **”të vetë organit”**.

Amendamenti 33

Neni 106.5, pas fjalisë së parë, fshihet teksti në tërësi.

Amendamenti 34

Neni 108, titulli i nenit 108, ndryshohet si vijon: **“Parimi i njoftimit të përshtatshëm”**.

Amendamenti 35

Neni 116, paragrafi 2, fshihen fjalët **“për efekt të këtij Ligji”**, zëvendësohen me fjalët **“për qëllim të këtij Ligji”**.

Amendamenti 36

Neni 124, paragrafi 6.2, riformulohet si vijon: **“palës së tretë i janë cenuar të drejtat apo interesat juridike nga akti administrativ që zgjidh ankesën”**.

Amendamenti 37

Neni 127 paragrafi 2. pas fjalës **“Pala”**, shtohet fjala **“e tretë”**.

Amendamenti 38

Neni 130, paragrafi 5, fshihet fjala “mund të”.

Amendamenti 39

Neni 135 paragrafi 2, pas fjalës “zbatohet” shtohet fjala “përshtatshmërisht”.

Amendamenti 40

Neni 138 paragrafi 3. fjalia e fundit “veprojë pa vonesë, sipas aktit administrativ të paraparë në paragrafin 2 të këtij neni”, riformulohet si vijon: “zbatoj pa vonesë aktin administrativ të lëshuar sipas paragrafit 2 të këtij neni”.

.

Amendamenti 41

Neni 142 paragrafi 2, të harmonizohet teksti i projektligjit në gjuhën angleze, me tekstin në gjuhën shqipe.

Amendamenti 42

Neni 144, paragrafi 1.4, referenca për nenin në gjuhën angleze, harmonizohet me gjuhën shqipe.

Amendamenti 43

Neni 149, paragrafi 1, në tekstin e projektligjit në tri gjuhët, referenca për nenin 154, ndryshohet në 153.

Amendamenti 44

Neni 155, paragrafi 2, në tekstin e projektligjit në gjuhën angleze, shtohet referenca 1 për nenin.

Amendamenti 45

Neni 156, paragrafi 2 dhe 4, fshihet “do të”.

3. Të ndryshme

Alma Lama, kërkoi nga kryetari i Komisionit që të thirret një mbledhje me pikën e rendit të ditës sipas email-it, që një anëtar i Bordit të RTK-së, u kishte dërguar anëtarëve të Komisionit, rreth shkeljeve ligjore e buxhetore në RTK dhe që vendimi për mbajtjen e mbledhjes me rendin e ditës sipas kërkesës së saj, të merret aty për aty.

Zenun Pajaziti, lidhur me plotësimin e agjendës, kemi lënë anash shqyrtimin e disa çështjeve. Kjo për arsye edhe të mungesës së deputetëve. Po ashtu, konfirmoi se ka qenë propozim i tij që Komisioni të takohet me Bordin e RTK-së, KPM-në dhe agjencitë e tjera që bien në fushëveprimin e Komisionit, por kuptohet që agjendën e Komisionit e caktojmë në bashkërendim edhe me zëvendëskryesuesit e Komisionit. Në këtë kontekst, tha se ditët në vijim

do të koordinohemi që edhe propozimin e znj. Alma, ta inkorporojmë si pikë të rendit të ditës për mbledhjen vijuese.

Xhevahire Izmaku, lidhur me kërkesën e znj. Alma, propozoi që Komisioni ta presë shqyrtimin e çështjes nga organet e drejtësisë, pasi që çështja është dërguar (adresuar), tek organet e drejtësisë, e pastaj çështja të diskutohet në Komision. Në këtë kontekst, ajo përmendi edhe pikëpyetjen lidhur me legalitetin e anëtarit të Bordit të RTK-së.

Alma Lama, u përgjigj se çështja e legalitetit për anëtarin e Bordit, nuk e pengon Komisionin për shqyrtimin e çështjes së propozuar.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

**Kryetari i Komisionit,
Zenun Pajaziti**
